



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. _____ Prot

Elbasan, më ____ / ____ / 2025

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS -“Blerje materiale elektrike ”

LLOJI PROCEDURËS- “Procedurë e hapur e thjeshtuar – mallra”- Marreveshje Kuader

KODI CPV – 31681410-0 - Materiale elektrike

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT - 3 749 738 (tre milion e shtateqind e dyzet e nente mijë e shtateqind e tridhjet e tete) **lekë pa t.v.sh,**

I mbajtur sot me date **28.01.2025** ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte:

Shtojca 8

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 te miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertes, sipas shtojces 1;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*
- c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Kriteret (a-c) jane vendosur ne perputhje me Dokumentat e Tenderit te miratuara nga APP bazuar ne Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar ne Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”

Pika b) eshte vendosur ne baze te nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periodhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 40 % e fondit limit te prokuruar.

2.2.2 Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifave vendore për vitin 2024 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së).(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqese vërtetimin per taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave

vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri **2.2.1** është përcaktuar duke u bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe referuar nenit 43 dhe nenit 55 VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

Kriteri **2.2.2** është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) **Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 55 pika 4 gërma "b" të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e mëposhtme :

➤ **EN-ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi.**

Certifikata e mesiperme duhet të jetë e leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kriteri 2.3.2 është vendosur ne perputhje me Nenin 40 pika 6 germa c te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar ne nenin 44 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar ne nenin 79 te LPP.

Ky kriter është vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikaten e menaxhimit te cilesise gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te AK qe ky OE do te ofertoje produkte te certifikuara te nje cilesie te mire e ne perputhje me standartet nderkombetare te cilesise.

2.3.3. Operatoret Ekonomik pjesmarres ne kete procedure prokurimi, duhet te paraqesin mostrat per elementet e meposhtem sipas preventivit dhe specifikimeve te kerkuara ne daten dhe oren e hapjes se tenderit ne ambientet e Agjencise se Sherbimeve Publike Rurale, adresa: Lagja Shkumbini Elbasan, konkretisht:

Nr.	EMERTIMI
1	Llampa Led 40 w me reduktor
2	Llampa 250 W hps sodium
3	Llampa led 15 W E-27
4	Fotoelemente (Rele Muzgu)
5	Drajver led 50 w
6	Konektore abonenti trefazore
7	Automate 63 A 1 Polar
8	Automate 63 A 3 Polar
9	Percjelles i Veshur 6 mm
10	Percjelles i Veshur 10 mm

Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kriteri 2.3.4 bazohet ne Nenin 40 pika 6,germa a) te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe është vendosur duke pasur parasysh numrin e konsiderueshem dhe natyren specifike te ketij produkti, per ti deshmuar autoritetit kontraktor se malli i ofruar ploteson kerkesat e pecaktuara ne dokumentat e tenderit.

Njësia e prokurimit

Ilda Tavanxhiu

Gazmend Gaxhja

Burbuqe Dedja